

VENDIM
Nr. 561, datë 29.7.2022

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT NGA MINISTRIA E
FINANCIVE DHE EKONOMISË TEK MINISTRIA E KULTURËS, TË NJË PJESE TË
PASURISË NR. 4/867, ZONA KADASTRALE 8270, ME EMËRTIM “GARDA E
REPUBLIKËS, GARNIZON”, TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 406, DATË 4.7.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë tek Ministria e Kulturës, të sipërfaqes truall 6 445 (gjashtë mijë e katërqind e dyzet e pesë) m², dhe të ndërtesës, me sipërfaqe 1 010 (një mijë e dhjetë) m², pjesë të pasurisë 4/867, zona kadastrale 8270, me emërtim “Garda e Republikës, Garnizon”, Tiranë, sipas plan-rilevimit bashkëlidhur këtij vendimi, me qëllim realizimin e projektit “Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë dhe Teatri i Kukullave”.

2. Sipërfaqet, pjesë të pasurisë, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, hiqen nga sipërfaqja e pronës së përcaktuar në pikën 1 të vendimit nr. 406, datë 4.7.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit nga Ministria e Brendshme tek Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë të pjesëve takuese të pronës, me emërtimin “Garda e Republikës, Garnizon”, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 8270, me numër pasurie 4/134, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 815, datë 29.11.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës shtesë të inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Brendshme, për Gardën e Republikës”, të ndryshuar.

3. Ministrisë së Kulturës i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pjesës së pasurisë së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.


KRYEMINISTËR
Edi Rama

PLAN RILEVIMI PËR PUNIME KADASTRALE

PRONARI DATË 20/05/2022 QËLLIMI PËR NDARJE PASURIE

VENDNDODHJA
BASHKIA TIRANË ZVASHK TIRANË JUG ZONA KADASTRALE 8270 NUMRI PASURISË 4/867 INDEX HARTË TR-T-11
TË DHËNAT E PASURISË
LLOJI PASURISË TRUALL SIP. PASURISË = 6445 m² SIPËRFAQE GJURMËS NDËRTIMIT = 1010 m² NUMRI KATEVE: 1 NUMRI PEMËVE _____

X = 484579.90 Y = 4575667.06 KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE X = 484774.64 Y = 4575667.06



X = 484579.90 Y = 4575537.70 SH 1: 1000 X = 484774.64 Y = 4575537.70

Nr.	ORIENTIMI	PËRDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHËNIME TË REALIZUESIT
1	VERI					
2	LINDJE					
3	JUG					
4	PERËNDIM					

REALIZOI PËR SUBJEKT PRIVAT
EMRI: Emirjeta GUZI
LICENCA: NR.NZ.7254/3 DATË 18/03/2019
KOMPANIA: GeoPoint-Al SH.P.K.
NIPT: L316150040
NËNSHKRIMI/VULA

REALIZOI PËR ASHK
SPECIALISTI _____
DVASHK _____
NËNSHKRIMI _____

KONFIRMOI
PËRGJEGJËSI/DREJTORI _____
NËNSHKRIMI / VULA _____

TEKNOLOGJIA E MATJEVE : T,G,S,O,Z

Kode për teknologjinë e matjeve: T-Terren; Z-Zyrë; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash;

PËRCAKTIMI KUFIRIT: K,HK

Kode për përcaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale;

SHENIME TE VEÇANTA:

KERKESË PËR NDARJE PASURIA

PRONARI/BASHKËPRONARËT-DEKLARIM MBI MARRËDHËNIET ME KUFITARËT

EMRI
NËNSHKRIMI _____

Kode për teknologjinë e matjeve dhe përcaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyrë; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale